



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 06.03.2018



RAPORT PËR MUAJIN SHKURT 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë kemi vazhduar me kontrollë të rendit të udhëtimit të transportuesve të udhëtarëve duke kujdestaruar edhe gjatë ditëve të vikendit me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve dhe largimit të transportit ilegal, ndërkaq është realizuar plani operativ në bashkpunim me PK-Njësi në Drenas, ku janë marr masat e radhes (konfiskim i targave dhe automjeteve të transportuesve ilegal).

Gjithashtu është bërë kontrollë dhe urdhëresë ndaj subjekteve afariste për hyrje në sistem të menaxhimit të mbeturinave nga Inspektori i Mjedisit.
Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar ka kryer inspektime të zakonshme rreth sanitarisë me rëndësi të veçantë në furrat e bukes dhe marketet, me q'rast ka konfiskuar rreth 38.75 kg mall me afat të skaduar.

Inspektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka vazhduar me procedura për ndërtimet në objektet banesore në Drenas të cilat janë duke u shëndrruar në objekte afariste. Gjithashtu ka qenë pjesë e Komisionit për vlerësim të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore dhe fakteqësive tjera duke shqyrtuar 12 kërkesa të tilla.

Inspektori i Komunikacionit ka bërë inspektime rreth transportit të udhëtarëve me rëndësi të veçantë, kontrollë e Operatorëve ilegal si dhe rendin e udhëtimit të Operatorëve legal, ndërkaq ka bërë konfiskimin e 11 targave dhe 2 automjeteve të transportuesve ilegal.

Inspektori i Tregut ka inspektuar bizneset e reja të pa regjistruara duke obliguar për tu pajisë me dokumentacionin e nevojshëm për biznes, gjithashtu ka mbyllë 4 subjekte të cilat nuk i plotësojnë kushtet për punë. Inspektori i Tregut gjatë këtij muaji ka qenë edhe pjesë e Komisionit për dhënjen e Lejes Mjedisore Komunale.

Inspektori Financiar ka vazhduar me inspektim dhe urdhëresë ndaj biznesve rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime të mjedisit në shqyrtim të kërkesave të palës dhe inspektimin e bizneseve rreth hyrjes së tyre në sistem të menagjimit të mbeturinave si dhe urdhëresë për furrat e bukes për tu pajisë me LMK.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punes në shifra për muajin shkurt 2018:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktivendime	Gjeba mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa nga Palët	Shqyrtim i Kërkesave	Mbyllje të lokalev	Konfiskim targav dhe automjeteve
I.Sanitare	14	2	4	2	2	1	1		
I.Tregut	10	4						4	
I.Financiare	9								
I.komunikacionit	23								11T,2A
I.Ndërtimit	9	4				3	3		
I.Ambientit	29					5	5		

mars, 2018

Shef i Inspekcionit: ARIANA SADIKU